




DPK/OMP

03-3593/13

02

29.10.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA

KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / OSNOVNI SUD ĐAKOVICA

Divizioni i kundërvajtjes

Nr.regj.04-479/2011

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, si gjykatë e shkallës së parë, me gjykatësen Diana Sina-Baraku, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse, kundër të pandehurës, Valdet Kurt Spahia, nga Gjakova. Për shkak të veprës kundërvajtëse nga lëmi i inspeksionit, e në bazë të nenit 73,74,195,198 al 1 pika 7 dhe neni 27 al 4 të Ligjit mbi kundërvajtjet. Me datën 23.09.2013, Gjykata mori këtë

AKTVENDIM

PEZULLOHET kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës, **Valdet Kurt Spahia, i lindur më 05.09.1961, nga Gjakova Rr "H. Dobruna", llamella 2/4**, se është ardhur deri të parashkrimi absolut i kësaj kundërvajtje.

Konform neni 198.al 1 pika 7 të L M K-së.

Me prurjen e këtij aktvendimi shfuqizohet aktvendimi i mëparshëm me nr.04-479/2011, te datës 24.09.2012, ne baze te nenit 217 alineja 1 te L M K.

ARSYETIM

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër korrupsionit në Prishtinë, nr.01-3236/2011, të datës 12.07.2011, është filluar procedura kundërvajtëse, kundër të pandehurit, Valdet Kurt Spahia, për shkak të kundërvajtjes nga lëmi i inspeksionit.

Gjykata me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, konstatoi se edhe pas ndërmarrjes së veprimeve nga kjo gjykatë, shihet se ka ardhur deri të parashkrimi absolut i ndjekjes më datën **23.09.2013**, për shkak se vepra kundërvajtëse është kryer më datën **12.07.2011**, në këtë rast kanë kaluar dy vite nga data kur është kryer kundërvajtja dhe për këtë arsye ka ardhur gjerë të parashkrimi absolut, andaj konform neni 27 alineja 4 te LMK-së.

Duke u bazuar në parashtrimet e më sipërme, Gjykata konform neni 198 alineja 1 pika 7te Ligjit mbi Kundërvajtjet. Pezullohet procedura për shkak të parashkrimit absolut.

Për sa u tha me larte u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES.

Nr.regj.04-479/2011, të datës 23.09.2013

GJYKATËSJA,
DIANA SINA-BARAKU.

03-3593/13/02
fey

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes se këtij aktvendimi dhe këtë Gjykatës së Apelit në Prishtinë- Departamentit të përgjithshëm- Divizionit të kundërvajtjes, e nëpërmes kësaj gjykate.